



VENDIM

Nr.24 Datë 11.02.2015

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “FUTURE ENERGY AL” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “P”; 5 pika 1 gërma “P”; 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**Future Energy AL**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë ” **Future Energy AL**” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në ”Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të licensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “**Future Energy AL**” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI